

KUNDRIM HISTORIK I DREJTSHKRIMIT TË TOPONIMEVE E ANTROPONIMEVE ANGLEZE E AMERIKANE NË GJUHËN SHQIPE

COMPLEXITY OF THE ORTHOGRAPHY OF THE ENGLISH NAMES IN THE ALBANIAN LANGUAGE THROUGH TIMES

ZAMIRA ALIMEMAJ

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, Departamenti i Gjuhës Angleze
Email: metaj_zana@yahoo.it; zalimema@univlora.edu.al

Përmbledhje

Toponimet e antroponimet e huaja, kur hyjnë në gjuhën shqipe krijojnë probleme shqiptimore, drejtshkrimore e gramatikore për shqipen standarde. Në Kongresin e Drejtshkrimit ky problem u diskutua e pati reagime. Pati dy qëndrime:

a) mbështetës të mendimit se këta emra duhej të shkruheshin sipas ortografisë së gjuhës prej nga merreshin, dhe

b) mbështetës të mendimit se këta emra duhej të shkruheshin sipas shqiptimit në gjuhën origjinale duke zbatuar ortografinë e gjuhës shqipe sipas parimit fonetik.

Por sot, kur anglishtja po bëhet gjuha globale, vemë re se edhe në gjuhën shqipe po krijohen një sere problemesh. Vihet re se krahas formave normative e në përputhje me rregullat e drejtshkrimit kanë filluar të shtohen rastet e thyerjeve të ndergjegjeshme të rregullave. Kjo vihet re sidomos në shkrimin e emrave të përveçëm anglezë (toponime e antroponime).

Ky artikull ka si qëllim të bëjë një kundrim historik të mënyrës se si janë shkruar këta emra, vecanrisht ata anglo-saksonë e amerikanë ndër vite, e të pasqyrojë rastet kur kemi thyerje të normës drejtshkrimore në shqipen standarde. Vihet re se shqiptarët kanë pasur probleme me drejtshkrimin e emrave të përveçëm të huaj në shqipe. Kjo ka bërë që përkthyesit të kenë pasur vështirësi në trajtimin e këtyre emrave, aq më tepër sot kur anglishtja po trajtohet si gjuha globale.

Fjalet kyçe: kundrim, toponimet, antroponimet, angleze, drjtshkrimi, shqipe, standarde

Abstract

Globalization is accompanied by significant cultural and linguistic complications. The most important

aspect is bilingualism. It is becoming a common phenomenon among the Albanians.

The impact of the globalization on Albania is very particular because of the language international isolation. Albania is making every effort to participate to the integration processes. All this represents a new phenomenon with a specific impact on the future development of the Standard Albanian. There is a real vogue for the use of anglicisms in newspapers and by the politicians. This phenomenon isn't new for Albanian. It has existed since 1908, time when the Congress of Manastir was held to make a unique alphabet for the Albanian Language. The influence of English could be seen in orthography and vocabulary of the Albanian Language in different articles written by Fan Noli, Fishta and other writers and translators in different newspapers and books written during that period of time.

The influence of English on Albanian is present even today. In its written form, Albanian is undergoing a process of mechanical reorientation to the English orthography. According to Albanian orthography, the English names are to be written with Albanian spelling. Nowadays this rule is widely violated. A particular case is the use of the English names without case endings. Even semantically there are many mistakes. Today many translators find it difficult to translate the Proper names from English into Albanian. I think that in wider perspective, it is needed to improve the teaching of the standard Albanian, and simluteniously, the foreign language teaching.

Hyrje

Në Kongresin e Drejtshkrimit u vendos që të zbatohet parimi fonetik edhe në drejtshkrimin e emrave të përveçëm të huaj, pra duhet të shkruhen sipas

shqiptimit të tyre në gjuhën prej nga janë marrë, por duke zbatuar ortografinë e gjuhës shqipe. Për një periudhë njëzetvjeçare kjo rregull është zbatuar mirë, por pas viteve '90 vëmë re se ky parim në të shumtën e rasteve nuk po zbatohet.

Shumëkujt nga ata që nuk e ka humbur ndjesinë e gjuhës shqipe u vjen keq kur shohin titujt e gazetave të mbushura me fjalë të huaja, sidomos anglisht, apo të dëgjojnë në mediet e folura të përdoren emra të përveçëm të huaj të cilëve u mungon çdo kategori gramatikore e drejtshkrimore e shqipes.

Vihet re se shqiptarët kanë pasur përherë probleme me drejtshkrimin e emrave të përveçëm të huaj në shqipe, sidomos me drejtshkrimin e emrave të përveçëm anglo-saksonë e amerikanë, sepse këta emra po marrin një shtrirje të gjerë në gjuhën shqipe

1. Drejtshkrimi i emrave të përveçëm deri në Kongresin e Drejtshkrimit. Çështja e alfabetit shqip dhe emrat e përveçëm

Dihet se qysh nga Buzuku më 1555, e deri në vitin 1908, kohë kur u mbledh Kongresi i Manastirit, për të shkruar shqipen janë përdorur 60 variante alfabetesh (Samara, 105), ndër të cilët po përmendim Ata ishin alfabetë të bazuara kryesisht në alfabetin latin, me ndonjë shkronjë të përzier nga alfabetet e gjuhëve të tjera. Për një popull të vogël siç është populli shqiptar, kjo përbente një katastrofë kulturore nga pikëpamja e zhdukjes së analfabetizmit. Librat që u shkruan nga priftërinjtë e Veriut p.sh. "Çeta e profetëve" e Bogdanit, nuk lexoheshin dot në Jugun e vendit, ku ishin të përhapura shkronjat greke.

Kjo gjendje shumëvariantëshe e alfabeve krijonte një kaos në shkrimin e shqipes dhe përbente një pengesë të madhe jo vetëm për përhapjen e shkrimit e të diturisë, por edhe për njësimin e gjuhës letrare

Në vitin 1908, në Kongresin e Manastirit, u pranuan dy alfabetë barasvlerëse, ai i Stambollit dhe ai latin që përdoret edhe tani. Pas Luftës së Parë Botërore, alfabeti i Stambollit, edhe pse kishte baza të mira shkencore, praktikisht nuk përdorej më, për shkak të vështirësive tipografike. Alfabeti latin, i cili në kohën e sotme quhet alfabeti i Manastirit, ishte sajuar mirë nga pikëpamja praktike, dhe shqipja, së paku përta i përket alfabetit, gjendej në një nivel ndërkombëtar. Mirëpo shqiptarët që ishin jashtë vendit e kishin të vështirë ta zbatonin këtë alfabet të ri.

Në atë periudhë, nga njëra anë, bota shqiptare nuk ishte kurrë e njëtrajtshme nga pikëpamja gjuhësore dhe, nga ana tjetër, zgjidhjet e Kongresit të Manastirit nuk mund të quheshin si të pagabueshme. Jashtë vendit ruheshin tradita të veçanta të drejtshkrimit. Ne shtypin e kohës, kjo gjë vihej re edhe në drejtshkrimin

e emrave të përveçëm të huaj, qofshin këto toponime apo antroponime.

1. Kjo gjë vihet re në botimet letrare të kohës.

Kështu, në mjaft vepra letrare të përkthyer në gjuhën shqipe përpara Luftës së Dytë Botërore emrat e autorëve të huaj shkruheshin si në gjuhën origjinale, kurse emrat e personazheve, herë shkruheshin si në gjuhën origjinale, e herë sipas shqiptimit në gjuhën prej nga merreshin duke zbatuar ortografinë e gjuhës shqipe. P.sh.

Në vitin 1907 Fan Noli botoi dramën e tij "Israilitë dhe Filistinë", ku përdori alfabetin e shoqatës shkodrane "Bashkimi". Këtu ai praktikonte shkrimin e emrave të përveçëm të huaj si në origjinal. Ai shkruante :

"... Populli i dheut shegnte te Israil-it..."

Kjo dramë u botua disa kohë përpara Kongresit të Manastirit. Në vitin 1910 në Paris u botua një libër shqip me autor Nikolla Lakon, që edhe ky po ashtu si Noli i shkruan toponimet si në gjuhën prej nga merreshin por ndryshe nga Noli i cili e veçonte mbaresën e rasës me vize ndarëse, Lako e shkruante të bashkangjitur.

"Njerës që kanë zakone të venë në liman te Liverpoolit n'Ingilte, a te Hambourgut ne Germani..."

2. Edhe në dokumente të kohës vihen re të njëjtat probleme. Shembuj mund të gjenden në gazetën "Dielli" 1909 në disa shkrime të Fishtës e Konicës.

"i çkelqyer profesor Dr. Holger Pedersen, nga Universiteti i Kopenhages me shkruan një letër të veçantë, nga e cila heq këto radhë për të venë re..."

(Bëhet fjalë për një letër ku Faik Konica shpreh qëndrimin e tij për mbledhjen e Kongresit të Manastirit).

Po kështu, në disa shkrime të Gjergj Fishtës vihet re se toponimet angleze shkruhen duke zbatuar ortografinë e gjuhës angleze.

Përta i përket përshtatjes në rasat e lakimit të gjuhës shqipe, herë vihet re veçimi i mbaresës me vizë, e herë shkrimi i saj bashkangjitur me emrin.

Edhe Kristo Floqi, i cili njihet si patriot që ka dhënë ndihmesë të konsiderueshme në mbrojtjen e gjuhës shqipe duke e vlerësuar e cilësuar atë si një nga gjuhët më të vjetra të Ballkanit, përdor ortografinë angleze në shkrimin e tij *"Albania the master key to the Neareast"* ("Shqypnija çils i pare i Lindjes s'afërme")

Edhe në radhët e gramatikanëve shqiptar ka pasur raste kur në shkrimet e tyre kanë shkelur normën drejtshkrimore të shqipes. Shkelje vihen re edhe në librin "Morfologjia historike e gjuhës shqipe", botim i vitit 1973. Po sjellim një shembull të shkëputur nga libri "Morfologjia historike e gjuhës shqipe" e Prof. Shaban Demiraj, botim i vitit 1973. Në parathënien lexojmë :*"...si rrjedhim i kontributevet të çmuara, që*

kanë dhënë në fushën e gramatikës historike të shqipes një varg gjuhëtarësh të shquar si **F. Bopp-i, G. Meyer-i...**"

Ne faqen 84 veçojmë : " *Edhe për V. Pisan-in.....*"

Në vitin 1967 u botua libri "Rregullat e drejtshkrimit të gjuhës shqipe" (projekt). Dalja e këtij projekti shënoi një sukses në hapat e para të përpjekjeve për njësimin e gjuhës shqipe. Këto rregulla u cilësuan si kodifikimi më i plotë e më sistematik i drejtshkrimit të gjuhës shqipe.

Në nëntor 1972 u mbledh Kongresi i Drejtshkrimit, ku u pat parasysh që në rregullat e drejtshkrimit te kombinohej drejt parimi fonetik me atë morfologjik e historik.

Një nga problemet që u diskutua ne Kongres ishte edhe drejtshkrimi i toponimeve e antroponimeve te huaja ne gjuhën shqipe Për rregullat se si duheshin shkruar këta emra pati dy qëndrime.

Qëndrimin të parë i përkisnin ata që përkrahnin mendimin se emrat e përveçëm të huaj duhej të shkruheshin sipas traditës vendase duke zbatuar drejtshkrimin e shqipes, sipas shqiptimit që kanë emrat e huaj në gjuhën prej nga merren.

Qëndrimi i dytë u përkiste atyre që përkrahnin mendimin se emrat e përveçëm të huaj duhej të shkruheshin sipas grafisë në gjuhën dhënëse.

2. Mendimet pro dhe kundër parimit fonetik në shkrimin e emrave të përveçëm të huaj

Para dhe pas Kongresit ishte shprehur mendimi se: "kur është fjala për emrat e përveçëm të njerëzve shqip, emrat e njerëzve s'kanë të bëjnë fare me rregullat drejtshkrimore, secili person ka të drejtë të shkruajë e të fiksojë emrin e vet ashtu siç i pëlqen e siç i vjen më mbarë atij."

Kishte dhe disa të tjerë që mendonin se emrat e njerëzve, në mos tërësisht, në pjesën më të madhe mund dhe duhet të kenë një sistem të caktuar drejtshkrimor. Palok Daka dhe përkrahësit e mendimit të tij, gjithashtu mendonin se:

"Meqë emrat e njerëzve përsëriten me mijëra herë nëpër akte, regjistra, dokumente, indekse alfabetike, duhet të ketë një rregull të caktuar për shkrimin e tyre, sepse nga shkrimi i saktë apo i gabuar i tyre varen, shpeshherë lehtësitë apo vështirësitë e veprimeve që lidhen me personat bartës të tyre."

Ata arsyetonin se, si fjalët ashtu edhe emrat e njerëzve, janë pasuri e përbashkët e gjuhës së popullit që i flet, por dallojnë nga njëri-tjetri në fushën e përdorimit dhe të funksionit të tyre. Ata gjithashtu mendonin se fjalët, si njësi kuptimore të gjuhës, të formuara historikisht kanë karakter shoqëror-kolektiv, ndërsa emrat e njerëzve si njësi që nuk kanë kuptim

leksikor por thjesht emërojnë, kanë karakter shoqëror-individual.

Pra, kjo do të thotë, se fjalët nuk mund të krijohen e as të zëvendësohen arbitrarisht me të tjera pa pëlqimin e kolektivit që i përdor. Emrat mund të krijohen ose dhe të zëvendësohen në rrethana të caktuara, arbitrarisht edhe nga individë të ndryshëm.

Emrat e njerëzve gjatë përdorimit të tyre të shpeshtë në të shkruar e në të folur, nga njëra krahinë në tjetrën na shfaqen grafikisht e fonetikisht më pak të qëndrueshëm dhe, për pasojë, më të ndjeshëm ndaj luhatjeve dhe shtrembërimeve se sa njësitë e tjera leksikore të gjuhës. Për këtë arsye, problemi i drejtshkrimit të emrave të përveçëm të huaj të dukej mjaft i ndërlikuar dhe ia vlente të diskutoj me kujdes.

3. Mendimi i Lirak Dodbibës dhe mbështetësve të tij, mbrojtës të drejtshkrimit sipas ortografisë shqipe

Diskutantët që u morën me trajtimin e drejtshkrimit të emrave të njerëzve në Kongresin e Drejtshkrimit ishin mbështetur kryesisht në të dhënat zyrtare të emrave të regjistruar në gjendjet civile të Republikës, si dhe në mjaft dëshmi të tjera të dorës së dytë. Nga të dhënat faktike të kohës, rezultonte se repertori kombëtar i emrave të njerëzve përbëhej nga disa shtresa heterogjene, të cilët mund të grupoheshin si më poshtë:

1) emra vendas me prejardhje nga sfera të ndryshme të leksikut konkret e abstrakt.

2) emra me prejardhje të huaj, të huazuar me rrugë e kohë të ndryshme, pjesërisht ose tërësisht të asimiluar ose dhe të paasimiluar.

3) emra të rastit, të shpikur, rrjedhimisht të paidentifikueshëm dhe të pamotivueshëm. Këta përbënin numrin më të vogël.

U vu re gjithashtu se deri në atë periudhë numrin më të madh e përbënin emrat që i përkisnin grupit të dytë d.m.th. emrat me prejardhje të huaj e të huazuar në kohë të ndryshme. Tek këta emra viheshin re shtrembërime dhe luhatje të theksuara, si në te shkruar ashtu edhe në të shqiptuar, si brenda të njëjtës krahinë, ashtu edhe nga njëra krahinë tek tjetra.

Në projektin e " Rregullave të drejtshkrimit " këshillohej që emrat e huaj të njerëzve dhe të vendeve të shkruheshin përgjithësisht sipas shqiptimit që kishin në gjuhën përkatëse në përshtatje me alfabetin e shqipes dhe me traditën e krijuar në gjuhën shqipe. Gjatë diskutimit u theksua se kritika e kishte pohuar dhe, madje, praktika e kishte vërtetuar se ky parim nuk ishte as më i mirë e as më i sakti, sepse ishte koha kur niveli kulturor i masave të popullit po ngrihej me ritme shumë të shpejta. Mësimi dhe përvetësimi i gjuhëve të huaja po bëhej një dukuri masive, prandaj në Kongres

u theksua se ky parim duhej rishikuar e duhej saktësuar më mirë. Sipas studiuësve mbështetës të këtij mendimi ekzistonin dy mënyra drejtshkrimi:

1. *Emrat e huaj, bartësit e të cilëve janë të huaj të shkruhen:*

a) sipas grafisë së gjuhës origjinale, më saktë sipas grafisë së gjuhës së bartësve të tyre, kur këta janë në origjinal me alfabet latin, duke dhënë në kllapa, të paktën një herë, edhe mënyrën e shqiptimit, dhe

b) sipas leximit, përkatësisht transkriptimit grafik, kur këta janë me alfabet jolatin.

Ky ishte parimi që zbatohet pothuajse në të gjitha gjuhët me alfabet latin. Ky quhej si parimi më i saktë e më shkencor.

1. *Emrat e huaj, ose me prejardhje të huaj, bartësit e të cilëve janë shqiptarë, duhet të shkruhen:*

a) sipas rregullave fonetike e morfologjike të gjuhës shqipe ose

b) sipas traditës të krijuar në gjuhën shqipe.

Ishte vënë re se shumë emra të huaj të përveçëm ishin shtrembëruar apo deformuar. Arsyet e këtyre deformimeve apo shtrembërimeve të emrave, sipas mendimit të këtyre studiuësve, e kishin burimin, ose nga perceptimi i gabuar dëgjimor a pamor i tyre nga përdoruesit, ose nga niveli i pamjaftueshëm kulturor e arsimor i vënësve të këtyre emrave si dhe i atyre që i regjistronin, si dhe nga pakujdesia që tregohej shpesh në shkrimin e tyre p.sh. *përdorej*

Holivert në vend të Olivert, apo

Alisë ose Heliza në vend të Eliza, dhe përdorej

Davidi apo Devidi, dhe Davidson ose Dejvidson apo Davidson e Devidsan.

Si përfundim, ata ishin të mendimit se, pavarësisht nga fakti se në ç'masë dhe sa u analizuan rastet që përbënin problem drejtshkrimor tek emrat e njerëzve, në rregullat e ardhshme të drejtshkrimit,

“parimi themelor i drejtshkrimit të emrave të njerëzve në gjuhën shqipe është e duhet të mbetet edhe për të ardhmen parimi fonetik.”

Madje, një studiuës i mirënjohur, Lirak Dodbiba thoshte se, shkrimi i emrave të përveçëm të huaj sipas shqiptimit të gjuhës së huaj është i pamundur të bëhet plotësisht i saktë, sepse gjuha shqipe nuk i ka të gjitha tingujt e gjuhëve të botës, si pasojë, shqiptimi i tyre do të shtrembërohet. Ai thoshte se ne nuk mund të dimë të shqiptojmë emrat në ato gjuhë që s'i dimë. Sipas tij, një problem tjetër ishte edhe vendosja e theksit në këta emra, sepse ndryshe, ata do të tingëllonin keq duke përdorur theksin sipas gjuhës shqipe. Ai gjithashtu, ishte kundër shkrimit me vizë lidhëse të emrave irlandezë me “O” përpara, por duhej që këta emra të shkruheshin me apostrof ashtu si dhe shkruheshin në gjuhën e vet. Si përfundim, ai thoshte:

“T'i qëndrojmë sa më afër parimit fonetik, domethënë gjuhës së folur, të mos gërmojmë në një hendek të thellë e të gjerë midis gjuhës së folur e gjuhës së shkruar; për këtë hendek ankohen gjuhëtarë e intelektualë në Francë e në Angli në gjuhët e veta.

Ky hendek, natyrisht, është i pashmangshëm, sepse është në vetë dialektikën e zhvillimit të gjuhëve, megjithatë sot për sot është në më dorën tone që hendeku të jetë sa më i cekët e sa më i ngushtë, që të mund të kapërcehet me lehtësinë më të madhe nga të gjithë, si nga ata me arsim të mesëm a të lartë historiko-humanitar, ashtu edhe nga ata me arsim të mesëm a të lartë tekniko-shkencor ose tekniko-profesional.

Drejtshkrimi duhet të jetë sa më i përdorshëm, kështu që të mos na duket penda parmendë.”

4. Mendimi i Thanas Shkurtit dhe mbështetësve të tij, mbrojtës të drejtshkrimit sipas ortografisë origjinale

Njëri prej tyre ishte studiuësi Thanas Shkurti, pedagog dhe njohës i mirë i anglishtes, i cili në kumtesën e tij thekson:

“Ne mendojmë se një gabim në të shkruar të fjalës së huaj është më i rëndë nga një gabim në të shqiptuar. Të shkruarit mbeten. Leximi ndreqet.”

Ai mendonte se emrat e përveçëm të huazuara nga anglishtja nuk mund të shkruheshin sipas shqiptimit të tyre në gjuhën origjinale, sepse zbatimi i parimit fonetik nuk mund të jepte gjithmonë përfundimet e pritura, sepse në të shumtën e herëve shqiptimi i huazimeve bëhej i gabuar ose i përafërt.

“Si rrjedhojë interpretimi i pasaktë fiksohet në një grafi jokorrekte që dhunon kërkesat e domosdoshme të drejtshqiptimit e të drejtshkrimit. Ky dhunim mund të pranohet nga e keqja për gjuhët që nuk përdorin alfabetin latin si rusishtja, greqishtja, arabishtja, kinezja. Por për fjalët e huazuara nga anglishtja është e domosdoshme ruajtja e grafisë origjinale”

Ai argumentonte duke thënë se, sistemi fonetik i anglishtes nuk përputhet me atë të shqipes. Alfabeti i gjuhës shqipe ka 36 shkronja dhe konsiderohet si alfabet i pasur, por gjithsesi nuk mund të japë shqiptimin e saktë të fjalëve të huazuara nga anglishtja, e cila ka 44 tinguj. Kjo na detyron t'i drejtohem grafikës angleze.

Nga ana tjetër, një drejtshkrim, që kërkonte të riprodhonte shqiptimin e anglishtes, nuk do të mund ta bënte këtë gjë në mënyrë të plotë; sepse do t'i duhej të linte pas dore një mori veçorish rreth intonacionit, intensitetit dhe tingujve subsidiare, elemente këto që janë shumë të rëndësishme për një riprodhim të saktë ortoepik.

Thanas Shkurti mendonte se ky drejtshkrim do të vjetrohej herët a vonë dhe, nga drejtshkrimi fonetik do të kthehej në drejtshkrim historik e etimologjik. E njëjta gjë ka ndodhur edhe me anglishten, e cila sot karakterizohet nga një drejtshkrim që largohet tepër nga shqiptimi.

5. Problemet e shtruara dhe diskutimet rreth tyre në Kongresin e Drejtshkrimit

Duke ndjekur parimin “ shkruaj si shqiptohet”, në drejtshkrimin shqip të emrave të përveçëm të huaj (toponime e antroponime) ishin vënë re këto shtrembërime:

5.1. Luhajtje fonetike

a) Luhajtje në bashkëtingëllore

(ç – sh): shuhet shpesh **Miçigan** në vend të **Mishigan** (shqiptimi sipas fjalorit të gjuhës angleze);

(b – v): p. sh. **Abram** në vend të **Avram**;

(d me dh; t me th): p. sh. **Teodor** në vend të **Theodor**;

b) Luhajtje në zanore

(u - a): p. sh. **Ulster** në vend të **Alster**; **Devid** në vend të **David**;

5.2. Deformime ortografike

Ishin venë re raste të emrave të huaj të shtrembëruar apo të deformuar të cilët ishin relativisht të shumtë e të ndryshëm. P. sh: *Dezdemonda, Distemona, Destamenta, Aliverta, Eliverta, Oliverta.*

Pra në drejtshkrimin shqip të emrave anglisht bëhej konfuzion ortoepik dhe ortografik i krijuar nga faktorët më të ndryshëm. Arsyet e shtrembërimit të emrave ishin nga më të ndryshmet. Ishin fiksuar shqiptime të gabuara që në caktimin fillestar të grafisë në katër lloj rrethanash:

1. Ndiqej shqiptimi i gjuhës nga ishte përkthyer, zakonisht nga rusishtja. Kështu që nga emrat e disa shkrimtarëve të mëdhenj kishin dalë format: **Tven (Twain), Gallsuorhi (Galsworthy), Jic (Yeats), Shekspir (Shakespeare), Oskar Uajld (Oscar Wilde)** etj.

2. Kishte raste të leximit të emrit sipas një gjuhe tjetër. Kështu për shembull, duke u nisur nga analogjia me drejtshkrimin gjerman, ishte transkriptuar gjermanisht emri i përveçëm amerikan dhe thuhej: **Shtainbek** në vend të **Stainbek** për **(Steinbeck)**, aponga frengjishtja, **Misuri** në vend të **Mizuri** për **(Missouri)**; dhe **Tekeri** në vend të **Thekëri** për **(Thackeray)**,

Sharli Shaplen në vend të **Çarli Çaplin** për **(Charlie Chaplin)**, **Shambelie** në vend të **Shembëlin** për **(Chamberlain)**.

3. Ngandonjëherë drejtshkrimi i disa emrave merrte forma plotësisht arbitrare, p. sh. **Alstë** për **Ulster**, **Beinad Sho** për **Bernard Shaw**.

4. Ishte fiksuar që gjithmonë grupi i bashkëtingëlloreve **ch** të lexohej **ç**, ndërkohë që nuk ndodhte gjithmonë kështu, p. sh. thuhej **Miçigan** (madje edhe sot vazhdon

të quhet kështu) në vend të **Mishigën** dhe **Çikago** në vend të **Shikagou**.

5. Në një numër rastesh të drejtshkrimit ishte vendosur një zgjidhje “lindore” duke u theksuar tiparet ballkanike të shqipes e duke u harruar natyra e saj latine. Ishte parapëlqyer më tepër modeli rus ose grek për drejtshkrimin e disa emrave, ku shkrimi i emrave të përveçëm bëhej vetëm sipas mënyrës së shqiptimit të tyre, pasi këta emra futen menjëherë në trajtën e alfabetit cirilik, përkatësisht alfabetit grek. Mirëpo, shqipja kishte një alfabet latin. Prandaj më kollaj ishte të shkruhej: **Mark Tuejn** e jo **Twain**, **Shekspir** e jo **Shakespeare**.

Po kështu thuhej: **Evropë** e jo **Europë**, **Nev Jork** për **New York**, **Vashington** për **Washington**.

Duke pasur parasysh të gjitha këto luhajtje apo deformime në drejtshkrimin e toponimeve apo antroponimeve me prejardhje nga gjuha angleze, studiuesi Thanas Shkurti propozoi që emrat e përveçëm të huazuar nga gjuha angleze të shkruheshin sipas ortografisë së gjuhës origjinale dhe të përdorej viza ndarëse për efekt të fleksionit.

Si përfundim, Kongresi vendosi: “*Shkrimi i emrave të përveçëm të huaj mbështetet përgjithësisht në shqiptimin e tyre në gjuhët përkatëse duke iu përshtatur sistemit grafik të shqipes. Me përjashtim të rr-së, bashkëtingëllore dyfishe të këtyre emrave nuk ruhen në shkrim në gjuhën shqipe. Në shfaqjen e pare të kësaj kategorie mund të shënohet në kllapa edhe shkrimi i tij sipas ortografisë vendase.*”

6. Kishte raste kur në gjuhën origjinale kishte shqiptime të sakta por alternative, (shqiptimet alternative janë shumë të shpeshta në gjuhën angleze) p.sh. emri **Raleigh** mund të shqiptohet [rëli], [raeli] dhe, [roli] në **Walter Raleigh**, në markën e veçantë të biçikletave; Qyteti, shteti ose lumi **Arkansas** lexohet [arkënsë] ose [arkoenzas].

Po kështu **Ruthven** lexohet [ruthvan] si emër njeriu dhe [rivën] si emër vendi në Aberdeenshire. Emri **Theobalds** është [tibaldz] për anglishten, por edhe [thiëboldz] si emër rruge në Londër.

Atëherë, kuptohet lehtë që, po t’i transkriptojmë të gjitha këto forma alternative sipas parimit fonetik, do të kemi aq versione ortografike sa janë format e shqiptimit, gjë që do të sillte çrregullime.

Përfundimet

Fjalët dhe emrat e përveçëm të huaj, kur hyjnë në shqipen standarde shkaktajnë probleme shqiptimore, drejtshkrimore e morfologjike. Një nga problemet që u diskutua në Kongresin e Drejtshkrimit ishte drejtshkrimi i emrave të përveçëm të huaj në gjuhën shqipe. Studjuesit, mund të themi, ishin ndarë në dy grupe: a) mbështetës të mendimit se emrat e

përveçëm të huaj duhej të shkruheshin duke zbatuar ortografinë e gjuhës prej nga merreshin , dhe b) mbështetës të mendimit se këta emra duhej të shkruheshin sipas shqiptimit të tyre në gjuhën origjinale por duke zbatuar ortografinë e gjuhës shqipe sipas parimit fonetik. Si përfundim u vendos që: *“Shkrimi i emrave të përveçëm të huaj mbështetet përgjithësisht në shqiptimin e tyre në gjuhët përkatëse, duke ia përshtatur sistemit grafik të shqipes”*. Kjo rregull u zbatua deri në dhjetëvjeçarin e fundit. Por, pas viteve '90, bashkë me ndryshimet ekonomike e politike në Shqipëri, u vunë re edhe probleme gjuhësore. Kështu, po shohim përditë e më shpesh se shkëlja e normës drejtshkrimore për emrat e përveçëm të huaj po lëshon shtat nëpër shkrimet në gazeta, në revista dhe në librat që përkthehen në gjuhën shqipe. Kjo ka marrë përmasa të tilla, sa që edhe disa prej gjuhëtarëve, kanë filluar të lëkunden në qëndrimin e tyre.

Të shkruarit e emrave të përveçëm të huaj është mënyra që e lehtëson mjaft punën kur dihet se si shqiptohet një emër i huaj, aq më tepër kur gjuha shqipe është një gjuhë e pasur me shumë fonema.

Që në Kongresin e Drejtshkrimit u parashikuan disa probleme që do të ishin prezent në të ardhmen në shqipe. Kështu, studiuesi Thanas Shkurti, në kumtesën e tij parashtroi disa prej problemeve që ishin prezent në drejtshkrimin e emrave të përveçëm anglez në gjuhën shqipe. Problemet që ai parashtronte tingëllojnë aktuale në ditët e sotme, sepse siç po e shikojmë në këto vitet e fundit, krahas formave normative e në përputhje me rregullat e drejtshkrimit, kanë filluar të shtohen rastet e thyerjeve të ndërëgjegjshme të rregullave, dhe, si pasojë, emrat e autorëve të ndryshëm të huaj, veprat e të cilëve përkthehen e botohen në shqipe po shkruhen sipas gjuhës origjinale. Kjo mënyrë e të shkruarit po bëhet shkak për thyerje të rënda të morfosintaksës shqipe.

Emrat nuk po lakohen sipas rasave dhe nuk po zbatohen kategoritë e ndryshme gramatikore si: shquarsia e pashquarsia, apo kategoria e numrit .

Zbatimi i rregullës drejtshkrimore është e lehtë për t'u zbatuar për atë pjesë të lexuesve që nuk di gjuhë të huaja, por krijon probleme për ata lexues që zotërojnë gjuhë të huaja, e aq më tepër gjuhën angleze e cila po bëhet gjuha e globit.

Disa prej problemeve që duhen zgjidhur janë: hartimi i bibliografive letrare e shkencore, katalogizimi dhe vendosja e veprave të të njëjti autor të huaj kur janë të botuar në origjinalin përkatës (ku emri i autorit është sipas drejtshkrimit në gjuhën përkatëse) dhe kur janë të përkthyer në shqip dhe ku emri i autorit, i

shkruar sipas normave të shqipes, nuk përputhet grafikisht.

Pra, të shkruarit sipas originalit përkatës ka të mirën se mban të patjetërsuar emrin e autorit dhe mbron vlerat anagrafike të emrit, porse, nga ana tjetër, shkakton edhe pëstjellim të vërtetë në shqiptimin e emrave të huaj, por kjo mënyrë e të shkruarit të këtyre emrave do të krijonte prishje të strukturës morfologjike të shqipes. Prandaj duhet vepruar me maturi për të gjetur zgjidhjen e duhur të këtij problemi jo pak të rëndësishëm për gjuhën shqipe. Duhet vepruar me shpejtësi e gjallëri sepse, siç shprehet studiuesi i mirënjohur i gjuhës shqipe Gjovalin Shkurtaj, *“mosreagimi ndaj thyerjeve të normës mund të lërë shteg për çarje e plasaritje të rënda të sistemit dhe të strukturës gramatikore të shqipes, të cilat pastaj do të ishte shumë e vështirë të ndreqen”*.

Bibliografia

- AJETI, Idriz (1992), »Alfabeti i Kristoforidhit dhe çështje gjuhësore në veprën e tij«: “K. Sh.”
- AJETI, Idriz & Lafe, Emil (), *Njëzet e pesë vjet nga Kongresi i Drejtshkrimit*.
- ASHSH (1973), *Drejtshkrimi i gjuhës shqipei*, Tiranë.
- BAJÇINCA, Isa (), *Rreth disa problemeve të shqipes letrare në Kosovë, 25-vjet K D*
- ÇELIKU, Mehmet (1982), »Shquarja e emrave të përveçëm në gjuhën shqipe«, *“Studime Filologjike” 2*, Tiranë.
- DOMI, Mahir (), *Alfabeti i gjuhës shqipe dhe Kongresi i Manastirit*
- ISLAMAJ, Shefkije (2003), *Vëzhgim rreth shqipes standarde në mjetet e informimit në Kosovë*. Konferenca 2003
- JORGAQI, Kristina (2002), »Vështrimi mbi drejtshkrimin e fjalëve me prejardhje të huaja në shqip«, *“Konferenca Shkencore 2002”*.
- KOSTALLARI, Androkli (1973), *Gjuha e sotme letrare shqipe dhe disa probleme themelore të drejtshkrimit të saj*, Tiranë.
- SHKURTAJ, Gjovalin (), *Onomastikë dhe Etnolinguistikë*
- SHKURTAJ, Gjovalin (2007), *Kushtrim për mbrojtjen e gjuhës*. Spekter, Tiranë.
- TOPALLI, N. (1991), »Rreth trajtës së toponimeve të huaja në shqipe«: *“Gjuha jonë” 2*, Tiranë.